



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 243, datë 14/12/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.109, datë 11.06.2021, së znj. M.Xh., ku pretendohet diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*² nga ana e Bashkisë Berat, nga z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat dhe nga z. A.K., Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin (MZSH), pranë Ministrisë së Brendshme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se përgjatë periudhës 13.02.2017-05.06.2017, ankuesja ka punuar në pozicionin e inspektorit të parandalimit, pranë Sektorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pranë Bashkisë Berat. Në vijim, përkatësisht në datën 05.06.2017, ajo është emëruar Shefe pranë të njëjtit Sektor dhe më pas është komanduar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pranë Bashkisë Berat.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi prove, ankuesja i përket shtresës së të përndjekurve politike dhe është kryetare e Shoqatës Kombëtare të të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve Politikë”, në qarkun Berat.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Mbështetur në shkresën nr. 4499/2, datë 01.10.2020, e Kryetarit të Bashkisë Berat, me lëndë *“Propozim për pezullim nga detyra”*, si dhe Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme, ankuesja është pezulluar nga struktura e shërbimit, ku bën pjesë, si pasojë e procedimit penal të filluar ndaj saj dhe të marrjes në cilësinë e të pandehurës, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Për sa më sipër, znj.M.Xh. sqaron se akuzat ndaj saj janë rrëzuar me Vendimin nr. 67, datë 08.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku është vendosur pushimi i akuzës/çështjes penale, për sa i përket procedimit penal në ngarkim të saj, lënë në fuqi me Vendimin nr.72, datë 29.04.2021, e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Pavarësisht sa më sipër, urdhëri i pezullimit të saj nuk është shfuqizuar dhe ankuesja nuk është rikthyer në detyrën e saj, të mëparshme. Znj. M.Xh. pretendon zbatimin e dy standardeve nga ana e subjekteve përkatëse, pasi punonjës të tjerë të larguar nga puna, si z. A.M. dhe z. D.G. janë rikthyer në punë, edhe pse çështjet gjyqësore në ngarkim të tyre nuk kanë përfunduar ende, ndërkohë që ajo mbetet ende e pezulluar edhe pse me vendim gjyqësor është pushuar procedimi penal ndaj saj.

Për këtë arsye, ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike të saj. Znj. M.Xh. thekson faktin se nuk është marrë me aktivitet politik, por i përket shtresës së të përndjekurve politikë, duke nënkuptuar bindjet e saj të djathta, si dhe është kryetare e Shoqatës Kombëtare të të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve Politike, në qarkun Berat.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 109, datë 11.06.2021, së znj. M.Xh., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua z.

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

E.D., Kryetar i Bashkisë Berat dhe nga z. A.K., Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin (MZSH), pranë Ministrisë së Brendshme, me shkresën nr. 888/1, datë 14.06.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankueses;
 - Kopje e librezës së punës, kontratës individuale të punës dhe të gjithë akteve të emërimit në detyrë për znj. M.Xh.;
 - Informacion mbi faktin nëse ndaj znj. M.Xh. janë marrë masa disiplinore gjatë periudhës që ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Berat. Nëse po, të dërgohen praktikat përkatëse për dhënie masash disiplinore;
 - Kopje të vlerësimeve në punë për ankuesen nga viti 2017 e në vijim;
 - Kopje e praktikës lidhur me pezullimin e znj. M.Xh.;
 - Informacion i hollësishëm mbi punonjësit e liruar nga detyra nga kryetari i Bashkisë Berat, për periudhën qershor 2019 – maj 2021 dhe cilat janë motivacionet e largimit të tyre nga puna;
 - Kopje e Vendimit nr. 67, datë 08.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Vendimit nr. 72, datë 29.04.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë;
 - Informacion mbi arsyet e mos shfuqizimit të Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të MZSH-së dhe mos rikthimit në detyrë të ankueses M.Xh.;
 - Informacion mbi mënyrën se si është menduar të procedohet me rastin e znj. M.Xh., pas vendimeve gjyqësore të sipërcituara, nëpërmjet së cilave është pushuar çështja penale në ngarkim të saj;
 - Kopje të akteve të largimit dhe rikthimit në detyrë për punonjësit z. A.M. dhe z. D.G., në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, pranë Bashkisë Berat;
 - Informacion mbi numrin e personave të larguar nga puna pranë Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, pranë Bashkisë Berat, nga muaji gusht 2019 e në vijim. Për secilin prej tyre të jepet informacion mbi motivin e largimit nga puna;
- Në përgjigje të shkresës nr. 888/1, datë 14.06.2021, së KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme MZSH (DPMZSH), pranë Ministrisë së Brendshme dërgoi shkresën nr. M-59/3, datë 23.06.2021, nëpërmjet së cilës informon se nëpërmjet shkresës nr. 4499/2, datë 01.10.2020⁵, me lëndë *“Propozim për pezullim nga detyra”* të Kryetarit të Bashkisë Berat është kërkuar pezullimi i punonjëses së shërbimit të MZSH-së, që mbante pozicionin Kryeinspektor zjarrëfikës, znj. M.Xh.. Kjo kërkesë mbështetej në faktin se ndaj saj kishte filluar procedimi

⁵ Shkresa nr. 2430, datë 07.10.2020, sipas regjistrimit dhe protokollimit të kryer nga Ministria e Brendshme;

penal dhe ishte marrë në cilësinë e të pandehurës, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, ka nxjerrë urdhërin e pezullimit nga detyra për këtë punonjëse, në zbatim të neneve 15 e 17 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, ku përcaktohet shprehimisht se emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit të lartë, të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, si dhe në rastet e fillimit të procedimit penal ndaj punonjësit të shërbimit të MZSH-së, pezullimi fillon në momentin kur punonjësi merret në cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj. Ndërkohë që, pikat 1, 3 dhe 7, të nenit 98, të VKM nr. 520, datë 25.07.2019 *“Për miratimin e Rregullores së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, përcaktojnë se punonjësi pezullohet në rastet e nisjes së procedimit penal dhe punonjësi merr cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj dhe pezullimi disiplinor i punonjësit zgjat deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor. Në këto raste, pezullimi disiplinor bëhet me urdhër të titullarëve, sipas pikës 5 të këtij neni dhe gjatë periudhës së pezullimit punonjësi i MZSH-së nuk trajtohet financiarisht.

Në shkresë sqarohet fakti se urdhëri i pezullimit për znj. M.Xh. vazhdon ende të ketë efekte, pasi nëpërmjet shkresës nr. 2052/1, datë 26.04.2021 me lëndë *“Informacion për vazhdimin e pezullimit ndaj punonjësës M.Xh.”*, të Kryetarit të Bashkisë Berat drejtuar DPMZSH-së kërkohet *“...vazhdimi i pezullimit nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Vlorë”*.

DPMZSH-ja mbetet në pritje të propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, lidhur me këtë punonjëse, situatë kjo, e parashikuar nga legjislacioni i sipërcituar.

Në vijim, në shkresën e DPMZSH⁶-së sqarohet se znj. M.Xh. është punësuar pranë Drejtorisë së Shërbimit Vendor të MZSH-së në Bashkinë Berat në datën 11.07.2016 dhe sipas DPMZSH, kjo punonjëse është punësuar si punonjëse e nivelit bazë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në germat ç) dhe e) të nenit 14 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, ku përcaktohet që të mos jetë përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike dhe të jetë i/e moshës nën 30 vjeç. Neni 17 i ligjit të sipërcituar përcakton rastet, kur punonjësi i shërbimit të MZSH-së ndërpret marrëdhëniet e punës, në rastet e lirimit ose përjashtimit nga ky shërbim. Punonjësi i MZSH-së lirohet nga shërbimi i MZSH-së edhe në rastin kur *“konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit”*, situatë kjo e parashikuar në germën c) të pikës 1, të nenit 17 të ligjit nr. 152/2015. Drejtoria e Shërbimit të MZSH-së në ministrinë përgjegjëse në kuadër të bashkëpunimit me kryetarin e bashkisë për zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri

⁶ Akronim i emërtesës *“Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes kundër Zjarrit dhe Shpëtimit”*;

dhe shpëtimi është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) nëpërmjet shkresës nr. 7534, datë 22.12.2017, me lëndë *“Kërkohej informacion për një ish punonjës të I.E.V.P. Berat”*. DPB⁷ ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 12430/1, datë 04.01.2018, duke dërguar informacionin e kërkuar. Bashkëlidhur shkresës sipërcituar është përcjellë edhe Urdhëri nr. 424/1, datë 03.07.2013 *“Për largimin nga detyra të një punonjësi civil”*, ku bëhet fjalë për znj. M.Xh., ish-punonjëse e IEVP Berat. Pas këtij momenti nga ana e DPMZSH-së është kërkuar respektimi i legjislacionit që normon këtë strukturë, pra aplikimi i dispozitës së sipërcituar. Ish-kryetari i Bashkisë Berat nuk pranoi të propozonte për lirimin nga detyra të kësaj punonjëseje sipas parashikimit të nenit 15 të ligjit nr. 152/2015, pavarësisht kërkesës së adresuar tek Kryetari i Bashkisë nga institucioni i Ministrisë së Brendshme.

Për sa më sipër, DPMZSH sqaron dhe informon KMD-në se znj. M.Xh. është pranuar si punonjëse e nivelit të mesëm në vitin 2017, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, nëpërmjet shkresës nr. 415, datë 01.02.2017 në funksionin e Inspektorit të MZSH-së, nëpërmjet Urdhërit nr. 67, datë 10.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së dhe i është dhënë grada Inspektor. Ankuesja është emëruar në funksionin e shefit të sektorit të inspektimit të MZSH-së në Bashkinë Berat, nëpërmjet urdhërit nr. 365, datë 05.06.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, mbështetur në propozimin e kryetarit të Bashkisë Berat, përkatësisht shkresën nr. 451, datë 01.02.2017. Znj. M.Xh. i është ekuivalentuar grada me gradën *“Kryeinspektor zjarrëfikës”* me Urdhërin nr. 107, datë 10.01.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme. Në vijim, ankuesja është pezulluar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, të kryer me shkresën nr. 4499/2, datë 01.10.2020 me lëndë *“Propozim për pezullim nga detyra”*. Procedura e komandimit të znj. M.Xh. si Drejtor i MZSH-së është bërë nga Kryetari i Bashkisë Berat.

Lidhur me çështjen për të cilën KMD kërkon informacion në lidhje me faktin nëse ndaj ankusesë janë marrë masa disiplinore, DPMZSH informon se nëpërmjet shkresës së saj nr. 2304/3, datë 17.06.2019 është dërguar *“Raporti mbi Kontrollin e Ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Vendor të MZSH-së në Bashkinë Berat”* pranë Bashkisë Berat. Nëpërmjet kësaj shkrese i është kërkuar Kryetarit të kësaj Bashkie, që në bazë të dispozitave të ligjit nr. 152/2015 dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional, Autoriteti Vendor (Kryetari i Bashkisë Berat) duhet të ndërmarrë menjëherë nismën për riparimin e mangësive të konstatuara duke mbajtur qendrim për shkeljet e konstatuara për punonjësit përgjegjës që rezultojnë me shkelje. Por, Kryetari i kësaj bashkie nuk ndërmori asnjë nismë për të kryer propozimet përkatëse ndaj punonjësve që rezultojnë me shkelje, sipas legjislacionit në fuqi.

Vlerësimet vjetore të punës për punonjësit e MZSH-së të nivelit të mesëm bëhen nga Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë, parashikuar kjo nga neni 7, i ligjit nr. 152/2015 dhe

⁷ Akronim i emërtesës Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

nga neni 62 i VKM-së nr. 250, datë 25.07.2010 *“Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”*.

Lidhur me urdhërat e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare të punonjësve të nivelit të mesëm A. M. (Urdhëri nr. 218, datë 31.10.2017) dhe D. G. (Urdhëri nr. 219, datë 31.10.2017), akte të cilat janë firmosur nga ish-Drejtori i Shërbimit të MZSH-së në nivel qendror janë konsideruar si akte absolutisht të pavlefshme nga ana e DPMZSH-së, duke iu referuar nenit 108 të KPA, pasi këto akte ishin nxjerrë në kundërshtim të plotë me nenin 15 të ligjit 152/2015, si dhe me kompetencën e organit publik kompetent. Këto akte janë refuzuar nga DPMZSH, për shkak të diskrecionit ligjor të përcaktuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2015, situatë për të cilën ish-drejtori i MZSH-së është shpallur fajtor nga gjykata kompetente.

Dy punonjësit e sipërcituar, të cilët e kanë kallëzuar znj. M.Xh. pranë organit të akuzës Berat, pavarësisht se nuk ishin përfshirë në strukturën e shërbimit vendor të MZSH-së në Bashkinë Berat, për ta nuk ekziston asnjë akt administrativ që t’ju ndërpresë marrëdhëniet administrative dhe financiare me strukturën vendore të MZSH Berat, çka nënkupton se ata duhet të përfshiheshin në listë prezencë deri në momentin e lirimit të tyre nga detyra nga autoriteti i përcaktuar në ligjin nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*.

Për sa më sipër, KMD bëhet me dije se punonjësi A. M. është rikthyer në detyrë me Urdhërin nr. 265, datë 18.08.2020, e Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me punonjësin D. G., i cili është rikthyer në detyrë me Urdhërin nr. 327, datë 06.10.2020, e Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, sërish me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat.

Lidhur me informacionin e patrajtuar në këtë shkresë, DPMZSH-s sqaron se ky informacion disponohet nga Bashkia Berat, pasi shërbimi zjarrëfikës është funksion i vetë këtij institucioni, parashikuar kjo në nenin 29/2, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* dhe ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*.

- Në përgjigje të shkresës nr. 888/1, datë 14.06.2021, së KMD-së, Bashkia Berat dërgoi shkresën nr. 3182/1, datë 25.06.2021, ku informon se ankuesja ka qenë e punësuar në pozicione të ndryshme pune në Sektorin e Shërbimit të Mbrojtjes kundër Zjarrit dhe Shpëtimit pranë Bashkisë Berat. Znj. M.Xh. ka filluar punë si punonjëse e nivelit bazë në Drejtorinë e MZSH Berat, me detyrë operator luftues, shpëtues në datën 19.07.2016. Më pas, ankuesja ka punuar në pozicionin e Shefit të Sektorit të Inspektimit e Parandalimit, pranë Sektorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Bashkinë Berat, duke filluar nga data 05.06.2017. Pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve politike nuk qëndron për arsye se Bashkia Berat nuk ka patur asnjë informacion, lidhur me bindjet politike të punonjësve. Bashkia Berat ka marrë dijeni me shkresën nr. 888/1, datë 14.06.2021, së KMD-së, se ankuesja është kryetare e Shoqatës Kombëtare të të Pushkatuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve

Politikë në Qarkun e Beratit. Në shkresë sqarohet se vlen të theksohet fakti se emërimi, lirimi si dhe pezullimi i punonjësve të nivelit të lartë dhe të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së nuk janë kompetencë e Kryetarit të Bashkisë, por të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së. Në referim të ligjit organik, Kryetari i Bashkisë ka vetëm të drejtën e propozimit për pezullim të punonjësve, por vendimmarrja është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, në bazë të nenit 15, të ligjit nr. 152/2015.

Bashkia Berat sqaron se ky fakt vërtetohet në bazë të Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së. Në kushtet kur, ankuesja është emëruar dhe pezulluar nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, nuk mund të pretendojë diskriminim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat.

Ankuesja është pezulluar për shkak të procedimit penal të iniciuar ndaj saj nga organi i akuzës dhe të marrjes së cilësisë së të pandehurës, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky pezullim është kryer në mbështetje të pikës 3, të nenit 15, si dhe pikës 2, të nenit 17 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”* referuar procedimit penal nr. 576, datë 26.07.2019, në ngarkim të saj. Pezullimi nga detyra i punonjësës është i mbështetur në ligj, për më tepër që nuk është kryer nga Bashkia Berat, për këto arsye pretendimet e ankueses për diskriminim për shkaqe politike nuk qëndrojnë. Pretendimi i znj. M.Xh. se është diskriminuar me argumentin se shtetasit A.M. dhe D.G. janë rikthyer në punë, Bashkia Berat sqaron se këta shtetas janë rikthyer në punë pas Vendimit nr. 731, datë 24.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku u vendos rikthimi i tyre në pozicionet e tyre të punës pranë Drejtorisë së MZSH-së, pranë Bashkisë Berat.

Bashkia Berat thekson faktin se jo vetëm nuk e ka diskriminuar znj. M.Xh., por përkundrazi ka marrë masa për revokimin e pezullimit të masës së pezullimit nga detyra të ankueses, pasi ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, shkresën nr. 2052 prot., datë 15.04.2020 *“Propozim për revokim të pezullimit nga detyra”*.

Bashkia Berat vë në dukje faktin se ka marrë dijëni për Vendimin nr. 273, datë 17.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku është vendosur mospranimi i kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me objekt: pushimin e procedimit penal nr. 600, datë 24.07.2018, për veprën penale *“shpërdorim detyre”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këto arsye, ankuesja vazhdon të jetë e pezulluar nga detyra deri në përfundim të hetimeve dhe marrjes së një vendimi të formës së prerë, i cili të deklarojë pafajësinë e ankueses për veprën penale të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal. Për sa më sipër, Bashkia Berat sqaron se i është kërkuar informacion prokurorisë në lidhje me këtë çështje.

- Në vijim të shkresës nr. 888/1, datë 14.06.2021, së KMD-së ankuesja M.Xh. ka depozituar shkresën nr. 888/4, datë 30.06.2021, si dhe ka dërguar e-mailin e datës 01.09.2021, ku sërish paraqet pretendimet e saj për diskriminim ndaj dy subjekteve të sipërcituara.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 888/5, datë 03.08.2021, së KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u realizua në datën 08.09.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesja M.Xh. së bashku me përfaqësuesin e saj ligjor⁸, përfaqësuesi me autorizim i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme dhe përfaqësuesit me autorizim të Bashkisë Berat.

Për sa më sipër, ankuesja parashtroi edhe një herë pretendimet e saj për diskriminim për shkak të bindjes politike nga ana e subjekteve të cituar në ankesë. Ajo sqaroi se është punësuar pranë Sektorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi pranë Bashkisë Berat. Nëpërmjet Urdhërit të datës 09.10.2020, ajo shprehet se është pezulluar nga struktura e shërbimit ku bën pjesë, si pasojë e një procedimi penal të filluar ndaj saj dhe marrjen e saj në cilësinë e të pandehurës për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ankuesja thekson faktin se urdhëri i pezullimit nuk është shfuqizuar, pavarësisht se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Apelit Vlorë kanë vendosur për pushimin e akuzës për këtë procedim penal. Arsyeja e mos shfuqizimit të aktit të pezullimit, sipas ankuses lidhet me faktin se ajo i përket shtresës së të përndjekurve politikë dhe është Kryetare e Shoqatës Kombëtare të të Përndjekurve Politikë dhe në këtë kontekst supozohet dhe mendohet se është e djathtë në bindjet e saj politike. E pyetur nëse ka anëtarësi në ndonjë forcë politike, ankuesja u shpreh se nuk është e angazhuar në ndonjë forcë politike dhe se ka status ushtaraku, fakt që bën të jetë e depolitizuar. E pyetur mbi faktin nëse një informacion të tillë ia kishte bërë të ditur punëdhënësit, ajo u shpreh se punëdhënësi kishte dijeni. E pyetur se cili ishte aktiviteti i saj si kryetare e kësaj shoqate, ajo u shpreh se ndihmonte të përndjekurit politik në çështje që kishin të bënin me kërkimin e të drejtave të tyre, për kërkimin e dëmshpërblimeve që duhet të përfitojnë në bazë të statusit të tyre. Ankuesja dorëzoi kopje të vendimeve të sipërcituara përkatësisht Vendimit nr. 72, datë 29.04.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Vendimit nr. 67, datë 08.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ankuesja thekson faktin se ajo i ka njoftuar shkresërisht të dy institucionet mbi vendimin e formës së prerë lidhur me akuzat penale, të ngritura ndaj saj, por Bashkia Berat e ka njoftuar mbi faktin se ka dërguar shkresa institucioneve për të kryer verifikime.

Në vijim e mori fjalën përfaqësuesi i ankuses. Ai u shpreh se gjatë gjithë karrierës së saj të punësimit, ankuesja është larguar për bindjet politike, sa herë ka qenë në pushtet Partia Socialiste. Pezullimi është i padrejtë pasi procesi i pezullimit duhet të kryhej në bazë të njoftimit të prokurorisë. Sipas tij, në konceptin ligjor, çështja duhet të trajtohet civilisht dhe jo penalisht. Kushdo mund të bëjë kallëzim në prokurori, dhe personi përkatës njofton Bashkinë Berat, e cila kryen pezullimin e punonjësit të kallëzuar, fakt që nuk ka sens. Sipas përfaqësuesit ligjor të ankuses, znj. M.Xh. ka status ushtaraku dhe nëse do të kishte kryer shpërdorim detyre, këtë

⁸ Deklarimi për përfaqësim u bë së seancë në prani të përfaqësuesve të KMD-së;

çështje duhet ta shqyrtonte Komisioni Disiplinor dhe vetëm nëse do të vendoste ky Komision, ajo do të pezullohej nga detyra.

Përfaqësuesi i Bashkisë Berat, z. A.M. sqaroi se ai ka depozituar kallëzim penal ndaj znj. M.Xh., ndërkohë që përveç këtij kallëzimi penal, së fundmi është depozituar edhe një tjetër që i përket çështjes nr. 600. Për këtë kallëzim penal, Bashkia Berat është njoftuar së fundmi nga organi kompetent.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së sqaroi se e kishte ndjekur nga afër rastin e znj. M.Xh.. Ai u shpreh se MZSH ka kompetenca të ndara në nivel qendror dhe vendor. Për punonjësit e nivelit të mesëm, propozimi për emërim apo largim nga puna duhet të kryhet nga ana e Kryetarit të Bashkisë. Në bazë të këtij propozimi vepron Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së. Në rastin e znj. M.Xh. ka patur një konflikt të mbartur nga ish-Kryetari i Bashkisë Berat. Neni 17 i ligjit për MZSH-në, si dhe neni 98, i VKM-së nr. 250, datë 25.07.2019 *“Për miratimin e rregullores së Shërbimit të MZSH-së”* parashikon procedurën e pezullimit nga detyra, specifikisht në rastet e fillimit të procedimit penal dhe pezullimi zgjat deri në momentin e ndryshimit të statusit të tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Znj. M.Xh. ka depozituar kërkesa të shumta për t’u rikthyer në detyrë, por ndodhur në kushtet kur, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së ka patur një kërkesë të parë nga Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet së cilës kërkohet shfuqizimi i pezullimit të ankueses dhe në vijim vetëm disa ditë më vonë është kërkuar sërish nga ky autoritet që pezullimi të vazhdojë për shkak të një procedimi të dytë penal ndaj saj, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së nuk ka vepruar.

Për sa më sipër, përfaqësuesit e KMD-së vunë në dukje faktin se pezullimi për një procedim penal nuk mund të jetë në fuqi edhe për një procedim penal, vijues.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së sqaron se ekziston një dualitet ndërmjet institucioneve, që nuk veprojnë dot pa njëri tjetrin, ndërkohë që institucioni që ai përfaqëson nuk ka patur dijeni lidhur me vendimin e formës së prerë që ka dalë në favor të ankueses. Znj. M.Xh. e kundërshtoi përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së duke theksuar faktin se ajo i ka njoftuar zyrtarisht Bashkinë Berat dhe Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së, lidhur me vendimin e formës së prerë, si dhe i ka dërguar vendimin e formës së prerë, bashkëlidhur shkresës së saj.

Përfaqësuesit e KMD-së u shprehën se nëse një kallëzim penal i dytë është depozituar për ankuesen, praktika përkatëse t’i vihej në dispozicion Komisionerit.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së sqaroi se institucioni që ai përfaqësonte kishte dijeni mbi faktin se ankuesja ishte larguar si pasojë e një situatë problematike me ish-punëdhënësin e saj, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pasi znj. M.Xh. ka punuar pranë IEVP Berat. Ai theksoi faktin se ankuesja është larguar nga detyra e juristes pranë kësaj IEVP-je, nëpërmjet një mase disiplinore, si dhe shprehu gatishmërinë për t’ia vënë në dispozicion Komisionerit aktet në fjalë. Ai vuri në dukje faktin se në bazë të legjislacionin përkatës mbi bazën e së cilit, funksionon

MZSH, nëse konstatohet se punëmarrësi është larguar me masa disiplinore nga punëdhënësi i mëparshëm, akti i emërimit për emërim pranë MZSH-së deklarohet i pavlefshëm. Përfaqësuesi i këtij institucioni u shpreh se Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së i është drejtuar zyrtarisht me shkresë ish-Kryetarit të Bashkisë Berat, ku i është kërkuar të merrte masa mbi këtë shkelje, pasi në bazë të ligjit për MZSH-në ankuesja nuk mund të punonte në rradhët e këtij shërbimi. Ish-Kryetari i Bashkisë Berat nuk ka pranuar të kryente propozimin për lirim nga detyra të znj. M.Xh., pavarësisht kërkesës së parashtruar nga Ministria e Brendshme.

Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesit e KMD-së i bënë me dije palët se çështja mund të zgjidhej me anë të ndërmjetësimit. Palët duhet të bien dakord lidhur me kushtet respektive që duhen plotësuar reciprokisht dhe në vijim Komisioneri do të vihet në dijeni nëse kjo marrëveshje është arritur ndërmjet tyre. Ankuesja theksoi faktin se kërkon rikthim në detyrë, ndërkohë që përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së u shpreh se nëse Bashkia Berat ia komunikonte në mënyrë zyrtare një fakt të tillë, ky institucion do të shprehej me anullimin e pezullimit dhe rikthimin e ankuses në detyrë.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Berat dërgoi shkresën nr. 3182/1, datë 20.09.2021, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se nga ana e këtij institucioni nuk është ushtruar asnjëherë asnjë formë diskriminimi ndaj ankuses. Kjo shpjegohet me faktin se pezullimi i ankuses është kërkuar rreth 2 vjet pas fillimit të hetimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat (data e regjistrimit të hetimit është pikërisht viti 2018, sipas të dhënave të organit të akuzës dhe në vendimet gjyqësore). Bashkia Berat ka kërkuar pezullimin e znj. M.Xh. në momentin e kalimit të çështjes së saj në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ndërkohë që, sipas ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, neni 17, pika 2, theksohet fakti se në rastet e nisjes së procedimit penal ndaj punonjësit të MZSH-së, pezullimi fillon në momentin kur, punonjësi merret në cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj. Në këtë kontekst, nëse Bashkia Berat do të kishte patur qëllime diskriminuese ndaj saj do ta kërkonte pezullimin që në vitin 2018, që përkon me datën e regjistrimit të çështjes në prokurori dhe jo në vitin 2020, kur çështja kaloi për gjykim në gjykatë, pra 2 vjet më vonë.

Për sa më sipër, Bashkia Berat sqaron se pas marrjes së kërkesës së znj. M.Xh. për revokimin e pezullimit të saj, me shkresën nr. 2052 prot., datë 15.04.2021 me lëndë “Propozim për revokim të pezullimit nga detyra” i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së pikërisht revokimin e pezullimit nga detyra. Në këtë moment, Bashkia Berat nuk ishte në dijeni se procesi ndaj saj nuk kishte përfunduar dhe pas dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja depozitoi kërkesën për revokim të pezullimit. Më datë 26.04.2021, punonjësi i MZSH-së, A.M. ka njoftuar Bashkinë Berat se procesi penal ndaj znj. M.Xh. ishte ende në vijim. Me marrjen e këtij njoftimi, Bashkia Berat i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, nëpërmjet shkresës nr. 2052/1, datë 26.04.2021, të vazhdojë pezullimin ndaj ankuses. Ky fakt tregon se Bashkia Berat ka vepruar me mirëbesim ndaj ankuses, ndërkohë që kjo e fundit e ka keqpërdorur këtë mirëbesim.

Bashkia Berat sqaron se në seancën dëgjimore të zhvilluar mbi këtë ankesë përfaqësuesit e këtij institucioni janë pyetur mbi faktin se përse nuk përfundon pezullimi i ankueses, pasi procedimi nr. 576, datë 26.07.2019, në ngarkim të ankueses ka përfunduar. Në këtë seancë përfaqësuesit e Bashkisë Berat kanë theksuar faktin se ndaj ankueses vazhdon ende të jetë në proces procedimi penal nr. 600, datë 17.05.2018. Ky procedim penal, sikurse shprehet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat në arsyetimin e vendimit të saj nr. 273, datë 17.05.2021, është kryer vetëm për çështjen nr. 576 të vitit 2019. Pra, të dyja çështjet janë ngritur për të njëjtën vepër penale, atë të shpërdorimit të detyrës. Ato kanë lidhje me njëra tjetrën, janë ngritur në të njëjtën kohë dhe rrjedhimisht duhet të përfundojnë të dyja pavarësisht se në vendimin nr. 330, datë 09.10.2020 është theksuar vetëm procedimi nr. 576, i vitit 2018 (sepse procedimi tjetër penal nr. 600, i vitit 2018 ende nuk ka kaluar ne gjykatë). Në pikën 1 të vendimit nr. 273, datë 17.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat citohet: *“Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Berat me objekt: “Pushimin e procedimit penal nr. 600, datë 24.07.2021 për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal.”*

Bashkia Berat thekson faktin se nga situata e krijuar (me shumë paqartësi) ky institucion filloi një hetim administrativ duke kërkuar një informacion nga institucionet kompetente. Me shkresën nr. 2512 prot., datë 12.05.2021 me lëndë *“Kërkesë për informacion ndaj ish-punonjësës znj. M.Xh.”*, Bashkia Berat iu drejtua IEVP Berat, ku ankuesja ka qenë e punësuar dhe është larguar me masën disiplinore *“Largim nga detyra”*. Me shkresën nr. 2512/2, datë 12.05.2021 datë 27.04.2021, Bashkia Berat i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe me shkresën nr. 2227 prot., i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Me shkresën nr. 899/1, datë 18.05.2021 *“Kthim përgjigje”* të IEVP Berat del qartë se masa disiplinore e ankueses është në fuqi⁹. Kërkesa e saj për anulimin e kësaj mase është rrëzuar nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me Vendimin nr. 3770, datë 15.10.2014, ku në pikën 2, theksohet *“rrëzimi i padisë”*. Gjykata e Lartë nuk e ka marrë çështjen në shqyrtim. Sipas ligjit, ky fakt përbën shkak për largimin nga detyra të ankueses sipas nenit 17, pika 1 dhe 2 gërma ç), të ligjit 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, ku përcaktohet se në raste të tilla *“konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit”*. Ndërsa, në nenin 14 *“Kriteret e pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-së”*, gërma ç), të këtij ligji përcaktohet se *“të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo institucionet e tjera të administratës publike”*. E gjitha kjo përbën shkak për largim nga detyra të znj. M.Xh.. Nga Bashkia Berat nuk është vepruar deri në sqarimin e plotë të situatës, në qoftë se do të kishte qëllime diskriminuese, sot ankuesja do të ishte larguar nga detyra.

Bashkia Berat thekson gjithashtu faktin se me gjithë qëllimin pozitiv të KMD-së për zgjidhjen e çështjes me pajtim, propozuar kjo në seancë dëgjimore të datës 08.09.2021, me faktet e paraqitura më sipër është e pamundur që Bashkia Berat të ndërmarrë një hap të tillë, pasi do të ishte në kundërshtim të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*.“.

⁹ Referuar shkresës nr. 3182/1, datë 20.09.2021, të Bashkisë Berat.

Bashkëlidhur shkresës së Bashkisë Berat janë dërguar në adresë të KMD-së aktet e cituara.

- Në vijim, ankuesja u paraqit në takim me përfaqësuesit e KMD-së, ku i bëri me dije se nëpërmjet Urdhërit nr. 6427/1, datë 08.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, ishte liruar nga struktura e këtij shërbimi, me motivacion *“për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë së aktit të pranimit”*, situatë e parashikuar nga gërma ç), pika 1 e nenit 17 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*. Nëpërmjet pikës 2, të këtij Urdhëri, është kryer gjithashtu edhe shfuqizimi i Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së *“Për pezullim punonjësi”*.

Ankuesja pretendon se lirimi i saj nga detyra është i padrejtë dhe se motivacioni mbi të cilin është larguar nga detyra është i pambështetur.

- Në vijim të takimit, ankuesja dërgoi shkresën nr. 1341/2, datë 09.11.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se nëpërmjet Urdhërit nr. 6427/1, datë 08.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, ajo është diskriminuar, pa njoftim dhe pa shkak, duke njollosur imazhin dhe figurën e saj si oficer me gradë *“Kryeinspektore zjarrfikëse”* me detyrë Shefe Sektori, pranë MZSH-së së Bashkisë Berat. Ankuesja sqaron se është drejtuese e suksesshme në menaxhimin e detyrave, gjatë vitit 2018 e 2019, fakt që ka rezultuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, kontrollet e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së dhe nga kontrolli i brendshëm i Bashkisë Berat. Ajo thekson faktin se pas 5 vitesh pune pranë MZSH-së Berat, duke patur gjithashtu edhe ngritje në detyrë, e në vijim pas një viti pezullim pa shkak, tashmë është larguar nga detyra. Ajo sqaron se ka mbajtur përgjegjësinë e Drejtorit të IEVP-së, Paraburgimit Berat, por një gjë e tillë është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në vijim, me Urdhërin nr. 4241, datë 08.07.2013 *“Për largimin nga puna të një punonjësi civil”* ajo është larguar nga detyra edhe pse e çliruar nga akuzat. Ajo thekson se është larguar nga puna për shkak të bindjes politike, pasi ka qenë e zgjedhur si kandidate për deputete për Qarkun Berat, përfaqësuese e Partisë Balli Kombëtar Demokrat, me sigël *“PBKD”*. Ankuesja sqaron gjithashtu se në librezën e saj të punës është shënuar *“largim nga puna pa motive”*.
- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, KMD iu drejtua Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, me shkresën nr. 1341/1, datë 02.11.2021, nëpërmjet së cilës shprehet si vijon: *““Komisioneri ju bën me dije se në referencë të nenit 15, pika 2¹⁰, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në asnjë rast institucionet publike apo subjektet private nuk mund të ndërpresin marrëdhëniet e punës me punonjësin, gjatë kohës që ankesa e tij është duke u shqyrtuar pranë*

¹⁰ Neni 15, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* të ndryshuar, parashikon: *“Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.”*

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë kontekst, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH dhe Bashkia Berat kanë shkëlur dispozitat e ligjit të sipërcituar.

Referuar sa më sipër, Komisioneri kërkon informacion me shkrim mbi situatën në fjalë, brenda datës 07.11.2021. Bashkëlidhur informacionit të kërkuar, të dërgohet pranë KMD-së, praktika e largimit nga puna të ankueses, si dhe dokumentacioni provues i motivacionit për lirim nga struktura e MZSH-së së znj. M.Xh..”

- Me shkresën nr. 5514/1, datë 11.11.2021, Bashkia Berat sqaron se: “Ankesa e znj. M.Xh. nr. 109, datë 11.06.2021 ka patur si objekt diskriminimin e saj, të pretenduar për shkak të pezullimit të saj nga detyra, për shkak të procedimit penal të filluar ndaj saj dhe të marrjes në cilësinë e të pandehurës për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Pra shkaku i ankimit të znj. M.Xh. nuk ka qenë ndërprerja e marrëdhënieve të punës, por pezullimi nga detyra. Sqarojmë gjithashtu se shkaku i largimit nga detyra e znj. M.Xh. ka ardhur si rezultat i hetimit administrativ, për mbledhjen e dokumentacionit të institucionet përkatëse, për të sqaruar pozitën e saj në raport me situatën e krijuar. Nga ky hetim u konstatua se akti i pranimit në detyrë të znj. M.Xh. ka qenë akt i pavlefshëm. Sipas ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, neni 17, pika 1, gërma ç) është një nga shkaqet e lirimimit nga detyra për punonjësit në shërbim. Kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi ishte një fakt që doli rishtazi, pavarësisht hetimit të kryer nga inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe nuk ishte objekt i këtij hetimi. Sipas ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” pavlefshmëria e aktit të emërimit në këtë shërbim, është kusht për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në çfarëdolloj rrethane që ndodhet punonjësi, që është emëruar me këtë akt të pavlefshëm. Theksojmë se për këtë pavlefshmëri të aktit nuk kemi qenë në dijeni më parë, prandaj në momentin e njohjes me këtë fakt ishim të detyruar të zbatonim dispozitivin e ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 17, pika 1, gërma ç). Së fundmi theksojmë se nuk jemi në kushtet e shkeljes së nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar që thekson: “Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës”, pasi theksojmë edhe një herë se znj. M.Xh. ishte ende në vijim të pezullimit të saj nga detyra, për shkak të procedimit penal të filluar ndaj saj dhe të marrjes në cilësinë e të pandehurës, për veprën penale të parashikuar në nenin 248 të Kodit të Penal. Pra, ajo vazhdonte të ishte e pezulluar dhe jo në marrëdhënie pune sipas kushteve të kontratës, sikurse thekson ligji.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 109, datë 11.06.2021, së znj. M.Xh., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat,

që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, si dhe mbi çështjet që janë objekt ankese.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Referuar akteve të depozituara në cilësi prove, rezulton se ankuesja M.Xh. ka filluar punë pranë MZSH-së Berat në datën 19.07.2016, në pozicionin e punës së operuesit luftues shpëtues, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 13.02.2017. Në vijim, znj. M.Xh. është pranuar si punonjëse e nivelit të mesëm, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, nëpërmjet shkresës nr. 415, datë 01.02.2017, në funksionin e Inspektorit të MZSH-së, nëpërmjet Urdhërit nr. 67, datë 10.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së dhe i është dhënë grada Inspektor. Më pas, znj. M.Xh. është emëruar në funksionin e Shefit të Sektorit të Inspektimit të MZSH-së në Bashkinë Berat, nëpërmjet Urdhërit nr. 365, datë 05.06.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, mbështetur në propozimin e Kryetarit të Bashkisë Berat, të kryer përkatësisht me shkresën nr. 451, datë 01.02.2017. Znj. M.Xh. i është ekuivalentuar grada me gradën *“Kryeinspektor zjarrëfikës”* me Urdhërin nr. 107, datë 10.01.2018, e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme. Në datën 29.12.2017, ankuesja M.Xh. është komanduar si Drejtore e MZSH-së Berat.

Për sa më sipër, vlen të theksojmë faktin se në bazë të nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 152/2015, parashikohet shprehimisht se: *“Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit të lartë dhe të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, me propozim të kryetarit të bashkisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.”* Në këtë kontekst, për këtë nivel punonjësisht, në çdo rast është i nevojshëm dualiteti *“Kryetar Bashkie - Drejtor i Përgjithshëm i MZSH-së”*.

Vetëm disa muaj pas komandimit të znj. M.Xh. në detyrën e Drejtoreshës së komanduar pranë MZSH-së Berat, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat janë depozituar dy kallëzime penale ndaj saj nga dy punonjës të MZSH-së, Berat, përkatësisht z. A.M. dhe z. D.G. Pozicionet e punës së dy punonjësve kallëzues janë suprimuar, nëpërmjet strukturës organike të MZSH-së Berat, rreth 2 muaj para se të komandohej znj. M.Xh. në pozicionin e punës së Drejtores së MZSH-së Berat. Kështu, në datën 24.07.2018, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve z. A.M. dhe z. D.G., në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat është regjistruar procedimi penal nr. 600, në ngarkim të znj. M.Xh., e akuzuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Akuza e tyre qëndron kryesisht në faktin se znj. M.Xh., në pozicionin e Drejtores së komanduar pranë MZSH-së Berat, që prej momentit të komandimit të saj në këtë pozicion, në mungesë të urdhërave të lirimimit nga detyra apo pezullimi ka kërkuar largimin e tyre forcërisht nga puna, nëpërmjet

policisë. Kallëzuesit sqarojnë se paraqiteshin çdo ditë në punë dhe kërkonin të kryenin detyrat e tyre funksionale, por nuk lejoheshin për të patur akses në ambientet e punës me urdhër të drejtoreshës. Sipas tyre, znj. M.Xh. ka kërkuar heqjen e tyre nga listëprezenca dhe listëpagesa në punë. Kallëzuesit theksojnë faktin se i kanë kërkuar Drejtoreshës së komanduar t'u vërë në dispozicion urdhërat e lirimt nga detyra, por askush nuk u jep informacion. Konkretisht në datën 14 dhe 18 pershor 2018, së bashku me Policinë Bashkiake, Drejtoresha M.Xh. ka kërkuar që në orën 08:00, ata të mos lejohen të futen në ambientet e punës.

Në datën 26.07.2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka regjistruar gjithashtu edhe procedimin penal me nr. 576, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A.M., i cili e ka kallëzuar Drejtoreshën e komanduar duke pretenduar se ajo ka shpërdoruar detyrën duke kryer veprime arbitrare ndaj tij dhe kolegut të tij D.G.

Për sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat paraqiti fillimisht para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. 600/2018, për shkak se pranë saj ishin depozituar dy kallëzime që bënin fjalë për të njëjtin fakt, si dhe për procedimin penal nr. 576, ishte konkluduar me marrjen si të pandehur të znj. M.Xh.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat është shprehur me vendimin nr. 273, datë 17.05.2021, nëpërmjet së cilit është vendosur mospranimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. 600/2018 me argumentimin se ishte e nevojshme që të administroheshin deklaratimet e shtetasit kallëzues, si dhe të paraqiteshin të dhëna më të detajuara lidhur me procedimin tjetër penal nr. 576/2019, lidhur me ecurinë e tij dhe vendimmarrjen eventuale të gjykatave.

Në vijim nga ana e Prokurorisë, me administrimin e fashikullit nr. 600/2018, të kthyer nga Gjykata janë administruar në procesverbal deklaratimet e shtetasit D.G., i cili ka shpjeguar faktet, të cilat i kishte paraqitur edhe në kallëzim. Ai ka pretenduar se e kallëzuara nuk i ka lejuar të ushtrojnë detyrën e tyre funksionale pa patur një urdhër të ligjshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së. Sipas tij, znj. M.Xh. nuk ka paraqitur listëprezencën e punonjësve në bashki me qëllim mos dhënien e pagës. Ai ka shpjeguar se ka ndjekur një proces gjyqësor administrativ, ku me vendimin nr. 731/2018 e Gjykatës Administrative Vlorë është vendosur detyrimi i MZSH-së Berat për t'i pranuar në punë dhe dhënien e pagave.

Pas regjistrimit të procedimit të dytë penal ndaj ankuses M.Xh., nëpërmjet Urdhërit nr. 479, datë 27.06.2019, të ish-Kryetarit të Bashkisë Berat, kjo e fundit është liruar nga kompetencat dhe detyrat e komanduara dhe të deleguara më parë, të Drejtorit të Shërbimit të MZSH-së, në Bashkinë Berat dhe duke filluar nga data 28.06.2019, ajo vazhdoi detyrën në pozicionin, ku ishte e emëruar më parë.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 152/2015, parashikohet shprehimisht se:

“Rregullat dhe procedurat për pezullimin disiplinor të punonjësit të shërbimit të MZSH-së përcaktohen në rregulloren e MZSH-së. Në rastet e nisjes së procedimit penal ndaj punonjësit të shërbimit të MZSH-së, pezullimi fillon në momentin, kur punonjësi merret në cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj.”

Në pikat 1, 2 dhe 3, gërma b) të nenit 98, të VKM nr. 520, datë 25.07.2019, “Për miratimin e rregullores së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” parashikohet shprehimisht se:

“1. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së pezullohet disiplinarisht nga detyra, me qëllim parandalimin e shkeljeve të tjera, ardhjen e pasojave ose ndikimin e tij në hetimin disiplinor.

2. Pezullimi disiplinor nga detyra nuk konsiderohet masë disiplinore.

3. Punonjësi pezullohet disiplinarisht nga detyra në rastet kur:

a) ka kryer shkelje të rënda disiplinore;

b) në rastet e nisjes së procedimit penal dhe punonjësi merr cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj;

.....”

Për sa më sipër, sikurse është theksuar edhe nga subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa, pezullimi disiplinor zgjat deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor. Gjatë periudhës së pezullimit, punonjësi i MZSH-së nuk trajtohet financiarisht.

Mbështetur në sa më sipër, në momentin e kalimit të procedimit nr. 576/2019 për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat¹¹, ankuesja është pezulluar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, të kryer me shkresën nr. 4499/2, datë 01.10.2020 me lëndë “*Propozim për pezullim nga detyra*”. Referuar Urdhërit nr. 330, datë 09.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së rezulton se ky pezullim i ankuses është bërë vetëm për procedimin penal nr. 576/2019, fakt që përcaktohet qartësisht në pjesën hyrëse të Urdhërit.

Procedimi penal nr. 576/2019 u shqyrtua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila u shpreh me vendimin nr. 67, datë 08.02.2021, ku u vendos pushimi i këtij procedimi ndaj ankuses. Vendimi i sipërcituar u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila u shpreh me vendimin nr. 72, datë 29.04.2021. Në bazë të këtij vendimi rezultoi se znj. M.Xh. nuk ka konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Në kushtet kur, procedimi penal nr. 576/2019 u pushua me vendim gjyqësor të formës së prerë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka depozituar kërkesën e datës 18.07.2021 për

¹¹ Procedimi penal nr. 576/2019 është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në datën 18.09.2021.

pushimin e çështjes penale nr. 600/2018, për sa kohë që të dyja procedimet penale trajtonin të njëjtin fakt të kallëzuar nga kallëzuesit A.M. dhe D.G.

Pas vendimit gjyqësor të formës të Gjykatës së Apelit Vlorë, ankuesja i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë Berat dhe Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, nëpërmjet kërkesës së datës 15.05.2021. bashkëlidhur së cilës, ka dërguar vendimet gjyqësore të sipërcituara dhe ka kërkuar kryerjen e procedurës për shfuqizimin e Urdhërit nr.330/2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, për pezullimin të saj, sipas dispozitave të ligjit nr. 152/2015 “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*” dhe VKM-së nr. 520, datë 25.07.2019, “*Për miratimin e rregullores së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*”.

Në përgjigje të kërkesës së ankueses, Bashkia Berat i ka dërguar shkresën nr. 2579/1, datë 17.06.2021, nëpërmjet së cilës e informon se nisur nga problematika e krijuar, për rastin e saj, ky institucion ka kërkuar informacion në institucionet përkatëse, me qëllim ndjekjen e procedurave administrative të mëtejshme për zgjidhjen e situatës së krijuar. Në shkresë theksohet fakti se Bashkia Berat është në pritje të përgjigjeve nga institucioneve, ku është kërkuar informacion dhe deri në mbërritjen e këtyre informacioneve ishte në vijim të procedurave për trajtimin e mëtejshëm të kërkesës së saj.

Ndërkohë që, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së ka dërguar në adresë të ankueses, shkresën nr. 2003/2 prot., date 29.06.2021, ku e sqaron se urdhëri i pezullimit nr. 330, datë 09.10.2020, për të vazhdon ende për shkak të shkresës së kryetarit të Bashkisë Berat nr. 2052/1, datë 26.04.2021, me lëndë: “*Informacion për vazhdimin e pezullimit ndaj punonjësës znj. M.Xh.*”, ku kërkohet “*...vazhdimi i pezullimit nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Vlorë*”. Ndër të tjera, në këtë shkresë theksohet fakti se DPMZSH-ja mbetet në pritje të propozimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, lidhur me znj. M.Xh., situatë kjo e parashikuar nga legjislacioni mbi MZSH.

Shkresa nr. 2052/1, datë 26.04.2021, e Bashkisë Berat, ku kërkohet të vijohet me pezullimin e znj. M.Xh., ishte dërguar në vijim të shkresës nr. 2052 prot., datë 15.04.2021, drejtuar DPMZSH-së ku ky institucion vihej në dijeni mbi vendimin nr. 67, datë 08.02.2021 dhe ndër të tjera në këtë shkresë e Bashkisë Berat citohet: “*Në këto kushte, në zbatim të ligjit nr. 152/2015: Bashkia Berat ka detyrimin t'i kërkojë në mënyrë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, për të vendosur për vazhdimin e pezullimit ndaj punonjësës apo rikthimin e saj në detyrë*”.

Për sa më sipër, në kushtet kur procedimi penal nr. 576/2019 është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ekzistonte detyrimi i subjekteve të sipërcituara për të proceduar për shfuqizimin e Urdhërit nr. 330/2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për pezullimin e znj. M.Xh. DPMZSH-së duhet të vepronte pas propozimit të Bashkisë Berat, e

cila në përgjigjen drejtuar ankueses, rezulton se ishte duke hetuar mbi punësimin paraardhës të saj dhe në këtë kontekst, nuk do të vepronte deri në mbërritjen e informacioneve përkatëse.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa kohë Gjykata e Apelit Vlorë është shprehur me vendim të formës së prerë lidhur me akuzën e znj. M.Xh. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës mbi procedimin penal nr. 576/2019 dhe pezullimi i ankueses nëpërmjet Urdhërit nr. 330/2020, të DPMZSH-së është kryer duke u mbështetur në këtë procedim penal, subjektet duhet të procedonin menjëherë për shfuqizimin e këtij akti.

Në rastin e punonjësve A.M. dhe D.G., të cilët kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me objekt *“shfuqizimi e konstatimi i pavlefshmerisë absolute të akteve administrative të lëshuara nga Drejtori i Mbrojtjes nga Zjarri, Berat”*, Bashkia Berat dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së kanë reaguar menjëherë pas daljes së vendimit nr.731, datë 24.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, nëpërmjet së cilit është vendosur rikthimi i tyre në pozicionet e tyre të punës pranë Drejtorisë së MZSH-së, pranë Bashkisë Berat. Ndërkohë që, në rastin e znj. M.Xh. është vepruar ndryshe, fakt që dëshmon ndjekjen e dy standardeve nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së.

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesit e Bashkisë Berat u shprehen se urdhëri i pezullimit nuk ishte shfuqizuar pasi ndaj znj. M.Xh. po kryhej ende një hetim penal, në kuadër të procedimit penal nr. 600/2018, ku ajo akuzohej për të njëjtën vepër penale dhe kallëzimi kishte të njëjtin objekt. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për procedimin penal nr. 600/2018 nuk ka dalë asnjë urdhër pezullimi për ankuesen. Urdhëri i pezullimit nr. 330/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së është miratuar vetëm për procedim penal nr. 576/2019 dhe jo për procedimin nr. 600/2018. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se arsyetimi i Bashkisë Berat dhe DPMZSH-së është i pajustificueshëm. Urdhëri i sipërcituar nuk mund të ketë fuqi juridike mbi një procedim penal, që nuk është i përfshirë në objektin e tij. Sikurse është cituar më parë në lidhje me këtë procedim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat kërkesë për pushimin e çështjes dhe kjo e fundit është shprehur me vendimin nr. 369, datë 19.10.2021, për pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e këtij procedimi penal ndaj ankueses.

Për sa më sipër, në kushtet kur, nuk ekzistonte më asnjë akuzë penale në ngarkim të znj. M.Xh. dhe duhej kryer menjëherë shfuqizimi i urdhërit të pezullimit nr. 330/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, ankuesja bëhet me dije se nëpërmjet Urdhërit nr. 6427/1, datë 18.10.2021, të këtij titullari lirohet nga detyra. Referuar aktit të sipërcituar rezulton se motivacioni i lirimit nga detyra konsiston në konstatimin e pavlefshmërisë së aktit të pranimit të saj në këtë shërbim, situatë kjo e parashikuar në gjurmën ç), pika 1, neni 17 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*. Ndërkohë që, në pikën 1 të

këtij akti është kryer lirimi i saj nga detyra, në pikën 2 të tij është shfuqizuar Urdhëri nr. 330/2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për pezullimin e ankueses. Urdhëri i lirimit nga detyra është mbështetur në shkresën nr. 4825, datë 28.09.2021, të Kryetarit të Bashkisë Berat me lëndë “*Kërkesë për largim nga detyra për punonjësen M.Xh..*”

Komisioneri konstaton se fillimisht ankuesja është liruar nga detyra e në vijim, është shfuqizuar akti i pezullimit të saj, për shkak të akuzës penale që ka patur në ngarkim. Njëkohësisht, shfuqizimi i Urdhërit nr. 330/2020, të DPMZSH-së duhej kryer në muajin maj 2021, moment në të cilin procedimi penal nr. 576/2019, është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo në muajin tetor 2021, pra rreth 5 muaj më vonë. Në kushtet kur ndaj ankueses po shqyrtohej hetimi nr. 600/2018, DPMZSH-së mund të miratonte akt vijues për pezullim në detyrë, por jo të përdorte një akt, i cili nuk ka si objekt këtë procedim penal ndaj ankueses. Hetimi i sipërcituar ka patur të njëjtin person të kallëzuar, objekt të njëjtë dhe subjekte të njëjta kallëzuese. Në këto kushte, me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, ky procedim penal është pushuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Nisur nga elementët e sipërcituar, ky procedim ka qenë i destinuar për t’u pushuar, pasi edhe në vërtetimin nr. 996 prot., datë 10.06.2021 të lëshuar nga prokuroria e sipërcituar është shënuar shprehimisht se ndaj znj. M.Xh. nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të saj.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesja është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së.

Në kushtet kur, shkarkimi nga detyra i ankueses nuk është objekt i ankimit të saj pranë Komisionerit, kjo çështje nuk mund të shqyrtohet në kuadër të ankesës nr. 109, datë 11.06.2021, pasi kërkon një hetim administrativ të posaçëm nga ana e strukturave hetimore të Komisionerit.

B. Shkak i mbrojtur “bindja politike”

Znj. M.Xh. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Bashkisë Berat, nga z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat dhe nga z. A.K., Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin (MZSH), pranë Ministrisë së Brendshme. Pretendimi i ankueses mbështetet në faktin se ajo i përket shtresës së të përndjekurve politikë dhe si e tillë është supozuar se ka bindje të djathta.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual,

karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesja ka depozituar gjithashtu në cilësi prove kopje të vendimit nr. 3382, datë 29.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilës është kryer regjistrimi i personit juridik “Shoqata Kombëtare e të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve politikë”, ku znj. M.Xh. është anëtare themeluese dhe Kryetare e kësaj shoqate. Njëkohësisht, ajo ka depozituar kopje të certifikatës së gjendjes familjare, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Qarkut Berat, Komuna Otlak, e datës 23.06.2009, (dokument i periudhës 20.03.1945 deri në 30.09.1991), ku rezulton se znj. M.Xh. është bija e z. Neshat Sherifi. Në bazë të vërtetimit nr. A-6793 prot., datë 06.06.1994 të Ministrisë së Rendit Publik, rezulton se, nëpërmjet vendimit nr. 28, datë 18.04.1994 të Komisionit të krijuar për verifikimin e kohës së vuajtjes së dënimit, z. N. Sh. i është njohur koha e internimit, dëbimit, për çështje politike, prej datës 10.03.1945 deri në datën 14.05.1954 dhe nga data 15.05.1954 deri në vitin 1966. Njëkohësisht, nga aktet e depozituara në cilësi prove rezulton se edhe anëtarë të tjerë të familjes së ankueses janë internuar për çështje politike. Për sa më sipër, KMD gjykon se të paturit e statusit të përndjekurit politik dhe prejardhja nga një familje me status të tillë, krijon supozimin se ankuesja ka bindje të djathta. Ky arsyetim mbështetet në faktin se Partia e Punës së Shqipërisë që ka drejtuar regjimin monist të asaj periudhe kohore, përgjatë së cilës familjarët e ankueses janë internuar për motive politike, ka patur bindje që i përkasin krahut të majtë. Ankuesja ka qenë e zgjedhur si kandidate për deputete për Qarkun Berat, përfaqësuese e Partisë Balli Kombëtar Demokrat, me sigël “PBKD”. Në parashtrimet e ankueses sqarohet fakti se në vitin 2013, ajo ka qenë e zgjedhur si kandidate për deputete për Qarkun Berat, si përfaqësuese e Partisë Balli Kombëtar Demokrat, me sigël “PBKD”. Në këto zgjedhje, ky subjekt politik ka garuar në koalicionin e djathtë Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim. Edhe në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25.04.2021, ky subjekt politik ka qenë pjesë e Aleancës për Ndryshim, ku sërish bën pjesë forcat politike të djathta. Ky fakt që përforcon bindjen e KMD-së për kahun e djathtë të bindjeve politike të ankueses M.Xh.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se znj. M.Xh. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së. Ankuesja pretendon diskriminim për shkak të bindjes

politike, pasi duke qenë pjesë e shtresës së të përndjekurve politikë në kohën e rregjimit monist, prezumohet se ka bindje të djathta.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe Shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Referuar Vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë¹², për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik, i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit”* (paragrafi 55).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Në nenin 12, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*,

¹² Redfearn v. The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;

parashikohet se: “1.Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ”

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative¹³ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Berat dhe DPMZSH-së të cilat duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar gjithashtu se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Berat, që duhet të provojë

¹³ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të bindjes së tij, politike.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹⁴ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁵

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *“të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i*

¹⁴ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht¹⁶”.

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të depozituara nga ankuesja, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pasi Urdhëri nr. 330/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për pezullimin e saj nga detyra nuk është shfuqizuar edhe pse procedimi penal nr. 576/2019 në ngarkim të saj është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Përsa i përket bindjeve politike të ankueses, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përkatësisht vendimit nr. 3382, datë 29.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilës është kryer regjistrimi i personit juridik “Shoqata Kombetare e të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve politikë”, rezulton se ankuesja është anëtare themeluese dhe Kryetare e kësaj shoqate. Njëkohësisht, ankuesja ka depozituar kopje të certifikatës së gjendjes familjare, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Qarkut Berat, Komuna Otlak, e datës 23.06.2009, (dokument i periudhës 20.03.1945 deri në 30.09.1991) ku rezulton se znj. M.Xh. është bija e z. N. Sh. Ky i fundit, në bazë të vërtetimit nr. A-6793 prot., datë 06.06.1994, të lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, rezulton se i është njohur koha e internimit, dëbimit, prej datës 10.03.1945 deri në datën 14.05.1954 dhe nga data 15.05.1954 deri në vitin 1966 për çështje politike nëpërmjet vendimit nr. 28, datë 18.04.1994. Njëkohësisht, nga aktet e depozituara në cilësi prove rezulton se edhe anëtarë të tjerë të familjes së ankueses janë internuar për çështje politike. Për sa më sipër, KMD gjykon se të paturit e statusit të përndjekurit politik dhe prejardhja nga një familje me status të tillë, krijon supozimin se ankuesja ka bindje të djathta. Kjo shpjegohet pasi Partia e Punës së Shqipërisë e cila ka drejtuar regjimin monist, përgjatë periudhës kur familjarët e ankueses janë internuar, ka patur kah të majtë bindjesh politike. Në parashtrimet e ankueses sqarohet fakti se në vitin 2013, ajo ka qenë e zgjedhur si kandidate për deputete për Qarkun Berat, si përfaqësuese e Partisë Balli Kombëtar Demokrat, me sigël “PBKD”. Në këto zgjedhje, ky subjekt politik ka garuar në koalicionin e djathtë Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim. Edhe në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25.04.2021, ky subjekt politik ka qenë pjesë e Aleancës për Ndryshim, ku sërisht bënin pjesë forcat politike të djathta. Ky fakt që përforcon bindjen e KMD-së për kahun e djathtë të bindjeve politike të ankueses M.Xh..

¹⁶ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Për sa më sipër, rezulton se Kryetari i Bashkisë Berat, z. E.D. është zgjedhur në këtë funksion, në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në kuadër të koalicionit Aleanca për Shqipërinë¹⁷.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*.

Në bazë të nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, parashikohet shprehimisht se emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit të lartë dhe të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, me propozim të kryetarit të bashkisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ankuesja M.Xh. ka gëzuar statusin e punonjësit të nivelit të mesëm drejtues. Në këtë kontekst, propozimi i Bashkisë Berat ka qenë iniciues për vendimmarrjen e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në të gjitha veprimet e ndërmarra ndaj ankueses. Nga ana tjetër, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së ka tagrën e institucionit vendimarrës, lidhur me çështjen e shkarkimit dhe pezullimit të znj. M.Xh. Nga hetimi administrativ rezultoi se ky institucion pavarësisht se u informua zyrtarisht nga ana e ankueses, mbi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Vlorë, nëpërmjet së cilës ankuesja lirohej nga akuza për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, sërisht nuk veproi për të shfuqizuar Urdhërin nr. 330/2020, e pezullimit të saj apo të kryente përpjekje institucionale për t’u informuar nga organet gjyqësore mbi këtë vendimmarrje, si dhe të vinte në veprim Bashkinë Berat, për të iniciuar procedurën për të shfuqizuar Urdhërin nr. 330/2019, të DPMZSH-së.

Për sa më sipër, Bashkia Berat në asnjë rast nuk e ka justifikuar me fakte dhe prova të mbështetura, vazhdimin e pezullimit të ankueses tej momentit të daljes së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për pushimin e procedimit penal nr. 576/2019, në ngarkim të saj. Komisioneri ka gjykuar se shfuqizimi i Urdhërit nr. 330/2020, të DPMZSH-së duhej kryer në muajin maj 2021, moment në të cilin procedimi penal nr. 576/2019 në ngarkim të ankueses, është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo në muajin tetor 2021, pra rreth 5 muaj më vonë. Në kushtet kur, ndaj ankueses po shqyrtohej hetimi nr. 600/2018 nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, DPMZSH mund të miratonte akt vijues për pezullim në detyrë, por jo të përdorte në vijimësi një akt, i cili nuk kishte si objekt këtë procedim penal ndaj ankueses. Hetimi i sipërcituar ka patur të njëjtin person të kallëzuar, objekt të njëjtë dhe subjekte të njëjta kallëzuese. Në këto kushte, me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, ky procedim penal është pushuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Nisur nga elementët e sipërcituar, ky procedim ka qenë i destinuar për t’u pushuar, pasi edhe në vërtetimin nr. 996 prot., datë 10.06.2021, të lëshuar nga prokuroria e sipërcituar është shënuar

¹⁷ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al,

shprehimisht se ndaj znj. M.Xh. nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të saj.

Përveç sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se në momentin, kur në ngarkim të ankueses nuk ekzistonte më asnjë akuzë penale dhe duhej kryer menjëherë shfuqizimi i urdhërit të pezullimit nr. 330/2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, mbështetur në shkresën nr. 4825, datë 28.09.2021, të Kryetarit të Bashkisë Berat me lëndë *“Kërkesë për largim nga detyra për punonjësen M.Xh.”*, ankuesja është shkarkuar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 6427/1, datë 18.10.2021, të këtij titullari. Motivacioni i largimit të saj nga detyra ka qenë i njohur edhe më parë nga institucionet përkatëse, të cilët vetëm në muajin tetor 2021, e kanë shkarkuar ankuesen. Në këtë kontekst, Komisioneri ka vënë re tendencën negative të institucioneve të sipërcituara ndaj ankueses, duke përshkallëzuar veprimet e tyre ndaj saj, deri në largim nga puna.

Referuar aktit të sipërcituar rezulton se motivacioni i lirimit nga detyra konsiston në konstatimin e pavlefshmërisë së aktit të pranimi të saj në këtë shërbim, situatë kjo e parashikuar në gërmën ç), pika 1, neni 17 të ligjit nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*. Ndërkohë që, në pikën 1 të këtij akti është kryer lirimi i saj nga detyra, në pikën 2 të tij është shfuqizuar Urdhëri nr. 330/2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për pezullimin e ankueses.

Komisioneri konstaton se fillimisht ankuesja është liruar nga detyra e në vijim, është shfuqizuar akti i pezullimit të saj, për shkak të akuzës penale që ka patur në ngarkim.

Në kushte, kur shkarkimi nga detyra i ankueses nuk është objekt ankese, KMD nuk mund të shprehet lidhur me këtë çështje, por një veprim i tillë i institucioneve respektive merret në konsideratë në kompleksitetin e veprimeve të ndërmarra ndaj ankueses.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja është diskriminuar për shkak të bindjes së saj politike, pasi është supozuar se ka bindje të djathta, pasi i përket shtresës së të përndjekurve politikë, nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikën 1, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të znj. M.Xh., për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak - bindja politike
Fusha - punësim
Lloji i vendimit - diskriminim